



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 156 Datë 12.11.2012

**PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC VLUSHE” SH.P.K,
PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 6.2 të liçensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike” dhe pikës 5.3 të liçensës së Tregtimit të Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HEC VLUSHE” sh.p.k për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Aurora Konstruksion” sh.p.k, ka transferuar të gjitha kuotat e saj prej 50% që posedon si ortakë tek shoqëria “HEC VLUSHE” sh.p.k subjektit “Anna Energia” sh.p.k duke dhënë dorëheqjen në këtë mënyrë nga posedimi i kuotave të zotëruara tek shoqëria “HEC VLUSHE”sh.p.k.
- Shoqëria “Roen Company” sh.p.k, ka transferuar 1% të kuotave nga 50% që zotëron tek shoqëria “HEC VLUSHE” sh.p.k shoqërisë “Anna Energia” sh.p.k.
- Në këto kushte ortakët aktual të shoqërisë “HEC VLUSHE” sh.p.k janë : Subjekti “Anna Energia” sh.p.k, e cila posedon 51% të kuotave të kapitalit themeltar dhe Subjekti “Roen Company” sh.p.k, e cila posedon 49% të kuotave të kapitalit themeltar.
- Subjekti “Anna Energia” sh.p.k, nga transaksionet e kryera rezultoi si ortakë mazhoritar që kontrollon interesat e shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi :

1. Të miratojë ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “ HEC VLUSHE” sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 156 Datë 12.11.2012

**PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC VLUSHE” SH.P.K,
PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|-----------------------|-------|--------|
| Sokol Ramadani | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Shkëlqim Bozgo | _____ | _____ |
| Adriatik Bego | _____ | _____ |